

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1235 Prot.

Tiranë, më 05.12 2016

VENDIM Nr. 137, datë 22.11.2016

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), si dhe Vendimit Nr. 2, datë 30.01.2009 të KKA "Rregullore mbi Kriteret e Ushtrimit të profesionit të arkeologut; Kriteret e gërmimit, dokumentimit dhe arkivimit të të dhënave dhe materialeve arkeologjike; Kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të arkeologut nga individë dhe subjekte private", Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 13 të datës 22.11.2016, pasi shqyrtoi *Kërkesën për pajisje me licencë profesionale individuale për veprimtari arkeologjike të tipit "A1" dhe "A2" të Z. Petrika Lera,*

VENDOSI:

1. Të mos miratojë *Kërkesën për pajisje me licencë profesionale individuale për veprimtari arkeologjike të tipit "A1" dhe "A2" të Z. Petrika Lera,* pasi nga informacioni i ardhur nga DRKK Korçë me shkresën Nr. 167 Prot., datë 27.05.2016 rezultoi se:
 - Në korrik të vitit 2014, Z. Petrika Lera ka kryer në ishullin e Maligradit gërmime arkeologjike të paligjëshme, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar) dhe vendimin e KKA për këtë projekt. Për këtë arsye DRKK Korçë ka kryer pezullimin e menjëhershëm të punimeve.
 - Z. Lera nuk ka bashkëpunuar me Institucionin e DRKK Korçë, në lidhje me gërmimet e kryera si drejtues i projektit, pranë fshatit Bezmisht, në vendbanimin prehistorik të Kallamasit, në zonën e Pustecit, si dhe nuk ka qenë korrekt me dorëzimin e raporteve periodikë të gërmimeve pranë këtij Institucioni.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al